



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 470/16 Prot

Tiranë, më 30.6.2017

URDHËR

Nr. 170, datë 30.6 2017

Mbështetur në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr.52/2014, "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", dhe Nr.106/2014, "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të procesverbalit të hetimit administrativ, provave të administruara dhe relacionit të Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në ngarkim të kontrolluesit "**Banka e Parë e Investimeve**", Tiranë,

K O N S T A T O V A:

Në zbatim të Urdhrit nr. 124, datë 26.04.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "**Banka e Parë e Investimeve**", me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë përpunimit të të dhënave personale të punonjësve.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "**Banka e Parë e Investimeve**", Tiranë, vëren se:

Kontrolluesi "**Banka e Parë e Investimeve**" ka si objekt të veprimtarisë tregtare ofrimin e shërbimeve bankare/financiare. Sa i përket kategorisë së subjekteve të të dhënave "punëmarrës" (punonjës), kontrolluesi i përpunon të dhënat personale manualisht dhe në format elektronik, në rrjetin e brendshëm kompjuterik, për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Të dhënat personale të punonjësve që përpunohen janë: emër, mbiemër, adresë banimi, dokument identifikimi, jeta profesionale, arsimimi, numër telefoni, adresë email, emër-mbiemër të familjarëve, shëndeti, gjendja penale.

Në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, kontrolluesi ka instaluar një sistem kamerash CCTV, në degët ku ushtron veprimtarinë dhe në ambientet e

brendshme të zyrave qendrore. Në zyrat qendrore janë instaluar 18 kamera, një pjesë e madhe e të cilave janë pozicionuar në ambientet e punës së punonjësve (referuar kamerave numër 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15).

Kontrolluesi ka hartuar një deklaratë nëpërmjet të cilës e informon punonjësën mbi faktin që ambienti është i survejuar me kamera për qëllime sigurie ndaj vjedhjeve ose kërcënimeve ndaj stafit. Kjo deklaratë nënshkruhet nga çdo punonjës.

Në pretendimet e paraqitura në formë shkresore (nr. 470/5 prot, datë 25.05.2017) dhe seancën dëgjimore datë 06.06.2017, të mbajtur në ambientet e Zyrës së Komisionerit, përfaqësuesit e kontrolluesit ndër të tjera paraqitën pretendimin se përdorimi i sistemit CCTV në ambientet e punës (zyra qendrore e bankës) është për arsyet:

- Për mbrojtjen e sigurisë së punonjësve, pronës, klientëve, dokumentacionit bankar, për të parandaluar dhunën ose vjedhjen brenda ambienteve të brendshme të punës;
- Për mbrojtjen e të dhënave që përpunohen, pjesë e aktivitetit bankar, për të parandaluar keqpërdorimin, dëmtimin e qëllimshëm etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e punës së punonjësve (zyrat qendrore) çënon privatësinë e punonjësve dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar), pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (garantimin e sigurisë), referuar Udhëzimit nr.3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi “Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar.

Kamerat nuk duhet të pozicionohen dhe të marrin imazhe nga ambiente të cilat nuk përputhen me qëllimin e mbikëqyrjes.

Instalimi dhe përdorimi i sistemit të videosurvejimit duhet të bëhet në atë formë që përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me të drejtat themelore të njeriut, të drejtën për privatësi dhe të drejtën për jetë private dhe familjare. Këto të drejta janë të mbrojtura nga neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut i miratuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, si dhe me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa i përket “Deklaratës së pëlqimit për punonjësit”, Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht informimit dhe shprehjes formale të vullnetit, (referuar edhe praktikës evropiane) ky vullnet rrezikon të mos jetë i lirë dhe i dëshiruar por potencialisht i imponuar nga marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës. Kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për realizimin e qëllimit. Në këtë kuadër, për realizimin e qëllimit duhet të përdoren mjete alternative që kanë impakt më të ulët në privatësi.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të CCTV në ambientet e punës, në kuadër të impaktit që ka mbi veprimtarinë e punonjësve, pasojat që sjell ndaj tyre dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së tyre, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse.

Neni 30, paragrafi 1, gërma "b" e ligjit të sipërcituar përcakton se: "Komisioneri ka këto të drejta: b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale".

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 27, 29, 30/1/b dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

#### URDHËROJ:

1. Kontrolluesi "**Banka e Parë e Investimeve**", të bllokojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale të siguruar nga kamerat e pozicionuara në ambientin e punës së punonjësve, në zyrat qendrore të saj.
2. Kontrolluesi "**Banka e Parë e Investimeve**", të kryejë heqjen e kamerave të pozicionuara në zyrat e punonjësve referuar pozicioneve të cituara më sipër.
3. Kontrolluesi "**Banka e Parë e Investimeve**", mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, brenda 30 ditëve.
4. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më, 30/6/2017

Bësnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI

